



Nr. 01/2024

Data: 06.02.2024

THIRRJE PUBLIKE

PËR MBËSHTETJEN E NDËRMARRJEVE MIKRO TË VOGLA DHE TË MESME, NË INVESTIMIN NË SISTEME TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME - Sistemi fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum

Që nga viti 2021, kriza energjetike nëpër të cilën po kalon Evropa ka përkeqësuar situatën me furnizim të qëndrueshëm me energji edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës. Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të prodhimit të brendshëm të energjisë elektrike, varësia nga importi dhe çmimet jostabile të energjisë elektrike në tregun ndërkombëtar, kanë krijuar pasiguri në furnizimin me energji elektrike. Një situatë e tillë vlerësohet që pengon edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, duke shkaktuar rrjedhimisht kosto të larta për ekonominë familjare si dhe për bizneset.

Ulja e konsumit përmes rritjes së Eficiencës së Energjisë (EE) ndikon në reduktimin e kërkesës për energji elektrike, duke ndihmuar familjet dhe bizneset për të reduktuar faturat e energjisë elektrike, por edhe përmirësuar sigurinë e furnizimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh këtë situatë të paqëndrueshme të furnizimit me energji, ka ndërmarr masa konkrete në adresimin e saj. Në linjë sipas Vendimit¹ Nr. 29/112, datë 13.12.2022, i plotësuar me Vendimin² Nr.03/128, datë 16.02.2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Planin e Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike në shumë prej shtatëdhjetë e pesë (75) milionë euro, si parakusht për përfitim të mjeteve financiare nga Bashkimi Evropian (BE) për Programin Vjetor IPA 2023.

Ky Plan parasheh zbatimin e masave me efekte të menjëhershme dhe afatshkurta, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare për familjet në nevojë dhe në disavantazh social për periudhën e dimrit, nxitjen e kursimit të energjisë nga konsumatorët familjarë, mbështetjen e familjeve përmes rritjes së Eficiencës së Energjisë (EE) në njësitë e banimit dhe të ndërtesave, si dhe investimeve në pajisje efikente dhe sisteme të energjisë së ripërtëritshme për familjet dhe Ndërmarrjet Mikro të Vogla dhe të Mesme (NMVM).

Bazuar në Masën 5 të Planit të Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike, Ministria e Ekonomisë (ME), shpall Thirrje Publike për mbështetjen e Ndërmarrjeve Mikro të Vogla dhe të Mesme (NMVM) në investimin në sisteme të

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>



energjisë së ripërtëritshme - Sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum.

1 MASA QË DO TË SUBVENCIONOHET PËR NDËRMARRJET MIKRO TË VOGLA DHE TË MESME (NMVM-të)

Instalimi i sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike.

Për t'u kualifikuar për subvencionim, ndërmarrja juaj duhet të jetë Mikro, e Vogël apo e Mesme sipas Ligjit Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja:

- Ndërmarrje Mikro (të ketë të punësuar deri nëntë (9) punëtorë³);
- Ndërmarrje e Vogël (të ketë të punësuar prej dhjetë (10) deri dyzet e nëntë (49) punëtorë³);
- Ndërmarrje e Mesme (të ketë të punësuar prej pesëdhjetë (50) deri dyqind e dyzet e nëntë (249) punëtorë³).

Secili aplikues gëzon të drejtën e përfitimit të subvencionit për vetëm një (1) sistem fotovoltaik (FV) për biznes, dhe sistemi duhet të blihet i ri.

³ Numri i punëtorëve për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) verifikohet direkt nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) për periudhën janar - dhjetor 2023.



2 KRITERET TEKNIKE DHE TË PËRGJITHSHME

Në tabelën më poshtë mund të gjeni kriteret për aplikim, kriteret teknike, vlerën e subvencionit dhe sqarimet shtesë për sistemin që do të subvencionohet.

Tabela 1.0

SISTEMI	KRITERET PËR APLIKIM	KRITERET TEKNIKE TË PAJISJES	VLERA E SUBVENCIONIMIT	SQARIME SHITESË
Sistemi fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum.	Kriteret për aplikim për fazën I: a. Të gjitha NMVM-të e lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV; b. Të gjitha NMVM-të e lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV me energji reaktive; c. Të ketë konsumin minimal vjetor në vitin e fundit ⁴ 4,000 ⁵ kWh/vit; d. Kapaciteti i propozuar për investim në momentin e aplikimit të jetë në përputhje me	<u>Modulet fotovoltaike (FV)</u> a. Modulet fotovoltaike (FV) duhet të jenë të kualifikuara konform IEC (International Electrotechnical Commission) aktuale apo certifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian (BE) siç janë:	Për kapacitetet instaluese 3-9 kWp , subvencionohet 250 €/kWp dhe deri në 2000.00 € . Për kapacitetet instaluese 10 kWp ose më shumë subvencionohet 200 €/kWp dhe deri në 6000.00 € .	

⁴ Periudhën kohore janar-dhjetor 2023.

⁵ Sqarim: Kërkesa e konsumit vjetor të energjisë elektrike prej 4000 kWh/vit buron prej faktit se projektet me fuqi të instaluar nën 3 kWp kanë kosto më të lartë për njësi, dhe efekti në kursim është shumë i ulët.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
the European Union

	<p>Rregulloren në fuqi për vetëkonsumatorët me Burime të Ripërtëritshme;</p> <p>e. Projekti duhet të jetë i përgatitur nga njëra prej kompanive instaluese të regjistruara në Republikën e Kosovës;</p> <p>f. Të ketë pëlqimin nga komuna përkatëse për projektin e propozuar në aplikim;</p> <p>g. Të ketë pëlqim për kyçje në rrjet nga KEDS-i (nga data e hyrjes në fuqi të rregullës për vetëkonsumatorët nga ZRrE-ja);</p> <p>h. Të ketë dëshminë që kompania nuk ka asnjë detyrim ose borxh ndaj ATK-së, apo është në marrëveshje të obligimeve tatimore me ATK-në.</p>	<ul style="list-style-type: none">• ISO – International Standardization Organization;• EN - European Standards;• IEEE Institute of Electrical and Electronics Engineers. <p>b. Fuqia nominale e moduleve fotovoltaike është > 250 Wp;</p> <p>c. Efiçienca e moduleve fotovoltaike (FV) në kushtet standarde të testimit (STC) të mos jetë më e vogël se njëzet përqind (20 %);</p> <p>d. Modulet fotovoltaike (FV) duhet të jenë të garantuara për së paku dhjetë (10) vite ndaj dështimeve për shkak të defekteve dhe cilësisë së materialeve;</p> <p>e. Modulet fotovoltaike (FV) duhet të kenë degradim linear të fuqisë jo më shumë se zero</p>	<p>Për bizneset në pronësi apo bashkëpronësi të grave nga pesëdhjetë e një përqind (51%) subvencionohet 200 € shtesë në total, për biznes. Pronësia dhe bashkëpronësia dëshmohet me certifikatë të biznesit.</p>	
--	---	--	--	--



	<p>Kriteret për aplikim për fazën II:</p> <ul style="list-style-type: none">a. Të ketë autorizimin nga ZRrE-ja (nga data e hyrjes në fuqi të rregullës për vetëkonsumatorët nga ZRrE-ja);b. Të ketë raportin e pranimit teknik të kapacitetit të instaluar nga KEDS-i për energjizim.	<p>pike tetë përqind (0.8 %) për vit deri në vitin e njëzet e pestë (25) të operimit (përfshijmë vitin të parë të operimit);</p> <ul style="list-style-type: none">f. Gama e temperaturës të mos jetë më e ulët se -30 °C deri + 50 °C;g. Korniza e moduleve fotovoltaike (FV) duhet të jetë e përbërë nga materiale rezistente ndaj korrozionit;h. Ngarkesa e lejuar e borës/erës: jo më pak se 5300 Pa / 2300 Pa. <p><u>Dizajnimi i strukturës për montimin e moduleve fotovoltaike (FV)</u></p> <ul style="list-style-type: none">a. Struktura montuese duhet të projektohet në atë mënyrë që të përballojë shpejtësinë e erës në zonat ku propozohet		
--	---	---	--	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
the European Union

		<p>të instalohen sistemet fotovoltaike (FV). Dizajni i strukturës për montimin e moduleve fotovoltaike (FV) në çati duhet të jetë i përshtatshëm me faktor të sigurisë jo më të vogël se 1.5</p> <p style="text-align: center;"><u>Invertori</u></p> <ol style="list-style-type: none">a. Invertori/ët duhet të jetë/jenë i/të kualifikuar konform IEC aktuale apo certifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian (BE);b. Invertori duhet të ketë garanci ≥ 5 vite;c. Eficienca maksimale e invertorit të mos jetë më e vogël se nëntëdhjet e shtatë përqind (97%);d. Gama e temperaturës të mos jetë më e ulët se $-20\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri +		
--	--	--	--	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
the European Union

		<p>50 °C;</p> <p>e. Gama e ndryshimit të frekuencës brenda: 45-55 Hz;</p> <p>f. Faktori i fuqisë në fuqinë nominale duhet të jetë më i madh ose i barabartë me 0.99;</p> <p>g. Shkalla e mbrojtjes (sipas IEC 60529): IP 65;</p> <p>h. Invertori duhet të ketë sistem mbrojtjeje të brendshme (të integruar):</p> <p>(i) Mbrojtje nga mbirryma në anën AC dhe DC,</p> <p>(ii) Mbrojtje nga mbitensioni/nëntensioni AC,</p> <p>(iii) Mbrojtje nga mbifrekuenca/nënfrekuenca AC,</p> <p>(iv) Mbrojtje kundër polaritetit të kundërt të lidhjes në anën DC,</p> <p>(v) Mbrojtje ndaj ishullit (anti-islanding),</p>		
--	--	--	--	--



		<p>i. Invertori duhet të jetë i pajisur me ekran për të monitruar të dhënat e paraqitura si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">(i) Fuqia DC në hyrje,(ii) Tensioni DC në hyrje,(iii) Rryma DC,(iv) Fuqia AC në dalje,(v) Tensioni AC në dalje,(vi) Rryma AC në dalje, <p style="text-align: center;"><u>Kabllo</u></p> <p>a. Kabllot duhet të jenë të kualifikuara konform IEC aktuale apo certifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian (BE);</p> <p>b. Kabllot duhet të jenë kompatible për sistemet fotovoltaike (FV) që mund t'i rezistojnë kushteve të vështira mjedisore, duke</p>		
--	--	---	--	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
the European Union

		<p>përfshirë temperaturat e larta, rrezatimin UV, shiun, lagështinë, papastërtitë, ekspozimin ndaj mikrobeve dhe tensionet sipas standardeve më të fundit të IEC.</p> <p><u>Kutitë shpërndarëse</u></p> <p>a. Të gjitha kutitë duhet të jenë të jenë të pajisura me elementet adekuate mbrojtëse, funksionalitetin e duhur dhe sigurinë (përfshirë siguresat, tokëzimin, etj.);</p> <p>b. Kutitë duhet të jenë të papërshkrueshme nga uji, parazitët, pluhuri, dhe duhet të jenë të prodhura nga materiale termoplastike / metalike në përputhje me IEC 62208, rezistent ndaj rrezeve UV (ultraviolete) dhe ndaj zjarrit, si dhe të ketë mbrojtje minimale me</p>		
--	--	--	--	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
the European Union

		IP 65 (ambient të jashtëm) dhe IP 20 (ambient të brendshëm).		
--	--	--	--	--



3 MËNYRA E APLIKIMIT PËR SUBVENCION

Aplikimi për subvencionim është i ndarë në dy (2) faza dhe në të dy (2) fazat aplikimi bëhet online përmes platformës e-Kosova.

Ju duhet të posedoni llogari individuale apo të biznesit përmes së cilës platforma e-Kosova do të identifikojë bizneset në të cilat jeni pronar apo përfaqësues i autorizuar. Aplikimi mund të bëhet nga aksionari/ët apo personi i autorizuar nga kompania.

Hapat për aplikim

Faza I

1. Sigurohuni që të plotësoni kriterin për aplikim në lidhje me konsumin e energjisë elektrike këtu: <https://ekosova.rks-gov.net/484>;
2. Shkarkoni formularin “Shtojca 1” nga platforma e-Kosova në linkun më lart dhe me ndihmën e kompanisë instaluese plotësoni dhe ngarkoni formularin;
3. Ngarkoni dëshminë nga ATK-ja që vërteton se biznesi nuk ka asnjë detyrim ose borxh ndaj ATK-së apo është në marrëveshje të obligimeve tatimore me ATK-në;
4. Ngarkoni dëshminë e marrjes së pëlqimit komunal nga komuna përkatëse për projektin e propozuar në aplikim;
5. Ngarkoni dëshminë e marrjes së pëlqimit për kyçje në rrjet nga KEDS-i (nga data e hyrjes në fuqi të rregullës për vetëkonsumatorët nga ZRrE-ja);
6. Ngarkoni fotografinë e sipërfaqes ku do të instalohen panelet solare fotovoltaike;
7. Certifikata e biznesit që dëshmon se biznesi është në pronësi apo bashkëpronësi të grave nga pesëdhjetë e një përqind (51%) (vlen vetëm në rastet kur biznesi është në pronësi apo bashkëpronësi të grave).

Pas verifikimit nga komisioni se dokumentacionet e kërkuara janë konform kriterëve, ju do të njoftoheni se jeni kualifikuar për këtë fazë dhe mund të vazhdoni me instalimin e sistemit fotovoltaike (FV) për prodhimin e energjisë elektrike sipas kriterëve teknike të specifikuar në thirrje. Për rezultatet e aplikimit në fazën I do të njoftoheni sipas afateve zyrtare, brenda dhjetë (10) ditë pune.

Vegëzën (linkun) për aplikim në fazën e dytë do ta pranoni në email adresën me të cilën e keni hapur llogarinë e juaj në e-Kosova.



Faza II

Pas instalimit të sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum sipas kritereve të specifikuara në thirrje, ju duhet të aplikoni për fazën II përmes platformës e-Kosova që të ju mundësohet përfitimi nga ky subvencion, duke ngarkuar dokumentet në vijim:

1. Kuponin fiskal apo faturën e rregullt me dëshmi të pagesës përmes transferit bankar, të blerjes së sistemit (***data e blerjes duhet të jetë nga data e shpalljes së thirrjes më 06.02.2024***);
2. Fotografji të sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum të instaluar sipas kritereve të specifikuara në thirrje;
3. Broshura e prodhuesit (data sheet) me specifikacionet teknike të moduleve fotovoltaike (FV) që dëshmon përmbushjen e kritereve për verifikim preliminar (Pika V e Shtojcës 1);
4. Broshura e prodhuesit (data sheet) me specifikacionet teknike të inventorit që dëshmon përmbushjen e kritereve për verifikim preliminar (Pika V e Shtojcës 1);
5. Dëshminë e autorizimit nga ZRrE-ja (nga data e hyrjes në fuqi të rregullës për vetëkonsumatorët nga ZRrE-ja);
6. Raportin e pranimit teknik të kapacitetit të instaluar nga KEDS-i për energjizim, sipas legjislacionit në fuqi;
7. Marrëveshja juaj e subvencionimit do të gjenerohet automatikisht në platformën e-Kosova. Kjo marrëveshje duhet patjetër të shkarkohet, të nënshkruhet, dhe të ngarkohet së bashku me dokumentet e sipërpërmendura.

Në këtë fazë ju kërkohet të vendosni numrin e xhirollogarisë bankare të biznesit e cila duhet të jetë në emër të biznesit dhe nga ndonjëra prej bankave të licencuara brenda Republikës së Kosovës.

Pas ngarkimit të dokumenteve të listuara më lart në platformën online e-Kosova, ju do të pranoni një (1) njoftim automatik me përmbajtjen: *“Aplikimi juaj është realizuar me sukses. Aplikacioni juaj do të vlerësohet nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë, i cili do të shqyrtojë nëse dëshmitë e ngarkuara në platformën e-Kosova janë konform kritereve të kësaj thirrjeje. Për rezultatet e aplikimit do të njoftoheni sipas afateve zyrtare”*.

Nëse aplikacioni juaj vlerësohet pozitivisht nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), ju do të njoftoheni përmes platformës e-Kosova dhe do të pranoni mjetet nga subvencionin në xhirollogari.

Sistemi fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike, duhet të jetë i instaluar dhe i gatshëm për inspektim nga momenti që aplikoni për fazën e dytë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
the European Union

Afati për aplikim

Afati i fundit për aplikim për fazën e parë është deri më datën **31 maj të vitit 2024**, ose deri në shpenzimin e buxhetit të alokuar për këtë thirrje. Aplikimet e pranuar në fazën e parë do të shqyrtohen bazuar në parimin “**KUSH APLIKON I PARI, SHËRBEHET I PARI**”, andaj inkurajoheni të aplikoni sa më herët.

Ndërsa, afati i fundit për fazën e dytë është deri më datën **30 shtator të vitit 2024**.

E drejta për ankesë

Aplikantët të cilët vlerësojnë se aplikimi i tyre nuk është vlerësuar drejtë nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), mund të ushtrojnë të drejtën e ankesës në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të njoftimit, konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Ankesa i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë (ME) si autoritet që ka publikuar thirrjen në email adresën: komisioni.ankesa@rks-gov.net

Sqarime shtesë

Për më shumë informacione dhe sqarime shtesë, rreth fazave të aplikimit mund të drejtoheni me shkrim në email adresën:

✉ info.subvencionet@rks-gov.net apo të kontaktoni në numrat e telefonit si më poshtë:

☎ 038 200 215 89

☎ 038 200 215 55

Nga e hëna deri të premten, duke filluar nga ora: 08:30-12:00 dhe nga ora 13:00-16:00



Shtojca 1: Formulari i aplikimit (plotësohet me ndihmën e kompanisë instaluese)

I. Të dhënat e aplikuesit	
Emri i biznesit:	
Numri unik i biznesit (NUI):	
Adresa e biznesit ku do të instalohet pajisja:	
Vendi:	
Numri i telefonit:	
Email adresa:	
Të dhënat e mëposhtme të plotësohen nga kompania instaluese	
II. Të dhënat elektro-energjetike	
Shifra e konsumatorit (KESCO ID):	_____ <input type="checkbox"/> Projekti i propozuar FV ka pëlqim nga KEDS
Niveli i tensionit të furnizimit:	<input type="checkbox"/> 0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive). <input type="checkbox"/> 0.4 kV Kategoria II.
Konsumi minimal vjetor në vitin e fundit:	<input type="checkbox"/> > 4,000 kWh
III. Të dhënat e sistemit fotovoltaiik (FV)	
Kapaciteti i sistemit FV:	_____ kWp
Prodhimi vjetor i sistemit FV:	_____ kWh
Konsumi vjetor i objektit:	_____ kWh
Kosto totale e sistemit FV:	_____ Euro
Kosto specifike e sistemit FV:	_____ Euro/kWp
Hapësira e mbuluar me module fotovoltaiike (FV):	_____ m ²



- Objekti i propozuar FV ka pëlqimin nga Komuna
 Objekti ka hapësirë të mjaftueshme në kulm për sistemin FV

IV. Implementuesi dhe deklarata mbi standardet teknike

Emri i biznesit instalues:	
Numri i biznesit instalues (NUI):	
E-mail adresa:	
Numri i telefonit:	

V. Kriteret e përzgjedhura për verifikim

Të dhënat për pajisjet:	Kriteri i kërkuar për verifikim (shëno me X nëse përmbushet kriteri).
<u>Modulet fotovoltaike (FV)</u>	<input type="checkbox"/> Eficienca e moduleve fotovoltaike (FV) në kushtet standarde të testimit (STC) të mos jetë më e vogël se njëzetë përqind (20 %). <input type="checkbox"/> Të pajisur me markën e konformitetit CE.
<u>Invertori</u>	<input type="checkbox"/> Eficienca maksimale e invertorit të mos jetë më e vogël se nëtëdhjetë e shtatë përqind (97%). <input type="checkbox"/> Të pajisur me markën e konformitetit CE.

VI. Kriteret minimale teknike të kërkuara (shëno me X nëse përmbushet kriteri)

Modulet fotovoltaike (FV)	Invertori
<input type="checkbox"/> Modulet fotovoltaike (FV) duhet të jenë të kualifikuara konform IEC (International Electrotechnical Commission) aktuale apo certifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian siç janë: <ul style="list-style-type: none"> • ISO – International Standardization Organization; • EN - European Standards; • IEEE Institute of Electrical and Electronics Engineers. <input type="checkbox"/> Fuqia nominale e moduleve fotovoltaike është > 250 Wp <input type="checkbox"/> Modulet fotovoltaike (FV) duhet të jenë të garantuara për së paku dhjetë (10) vite ndaj dështimeve për shkak të defekteve dhe cilësisë së materialeve. <input type="checkbox"/> Modulet fotovoltaike (FV) duhet të kenë degradim linear të fuqisë jo më shumë se zero pikë tetë përqind (0.8 %) për vit deri në vitin e	<input type="checkbox"/> Invertori/ët duhet të jetë/jenë i/të kualifikuar(a) konform (International Electrical Code -IEC). aktuale apo certifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian (BE). <input type="checkbox"/> Invertori duhet të ketë të garanci ≥ 5 vite. <input type="checkbox"/> Gama e temperaturës të mos jetë më e ulët se - 20 °C deri + 50 °C. <input type="checkbox"/> Gama e ndryshimit të frekuencës brenda: 45-55 Hz. <input type="checkbox"/> Faktori i fuqisë në fuqinë nominale duhet të jetë më i madh ose i barabartë me 0.99. <input type="checkbox"/> Shkalla e mbrojtjes (sipas IEC 60529): IP 65 <input type="checkbox"/> Invertori duhet të ketë sistem mbrojtjeje të brendshme (të integruar): <ul style="list-style-type: none"> (i) Mbrojtje nga mbirryma në anën AC dhe DC, (ii) Mbrojtje nga mbitensioni/nëntensioni AC, (iii) Mbrojtje nga mbifrekuenca/nënfrekuenca AC,



njëzet e pestë (25) të operimit (përfshirë vitet të parë të operimit).

Gama e temperaturës të mos jetë më e ulët se -30 °C deri + 50 °C

Korniza e moduleve fotovoltaike (FV) duhet të jetë e përbërë nga materiale rezistente ndaj korrozionit

Ngarkesa e lejuar e borës/erës: jo më pak se 5300 Pa / 2300 Pa.

Dizajnimi i strukturës për montimin e moduleve fotovoltaike (FV)

Struktura montuese duhet të projektohet në atë mënyrë që të përballojë shpejtësinë e erës në zonat ku propozohet të instalohen sistemet fotovoltaike (FV). Dizajni i strukturës për montimin e moduleve fotovoltaike (FV) në çati duhet të jetë i përshtatshëm me faktor të sigurisë jo më të vogël se 1.5.

Kabllo

Kabllot duhet të jenë të kualifikuara konform IEC aktuale apo certifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian (BE).

Kabllot duhet të jenë kompatible për sistemet fotovoltaike (FV) që mund t'i rezistojnë kushteve të vështira mjedisore, duke përfshirë temperaturat e larta, rrezatimin UV, shiun, lagështinë, papastërtitë, ekspozimin ndaj mikrobeve dhe tensionet sipas standardeve më të fundit të IEC.

Të pajisur me markën e konformitetit CE.

(iv) Mbrojtje kundër polaritetit të kundërt të lidhjes në anën DC,

(v) Mbrojtje ndaj ishullit (anti-islanding)

Invertori duhet të jetë i pajisur me ekran për të monitoruar të dhënat e paraqitura si më poshtë:

(i) Fuqia DC në hyrje,

(ii) Tensioni DC në hyrje,

(iii) Rryma DC,

(iv) Fuqia AC në dalje,

(v) Tensioni AC në dalje,

(vi) Rryma AC në dalje.

Kutitë Shpërndarëse

Të gjitha kutitë duhet të jenë të pajisura me elementet adekuate mbrojtëse, funksionalitetin e duhur dhe sigurinë (përfshirë siguresat, tokëzimin, etj.).

Kutitë duhet të jenë të papërshkrueshme nga uji, parazitët, pluhuri, dhe duhet të jenë të prodhuar nga materiale termoplastike / metalike në përputhje me IEC 62208, rezistent ndaj rrezeve UV (ultraviolete) dhe ndaj zjarrit, si dhe të ketë mbrojtje minimale me IP 65 (ambient të jashtëm) dhe IP 20 (ambient të brendshëm).

Të pajisur me markën e konformitetit CE.

Deklaroj se projekti: **Instalimi i sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike** është në përputhje me kërkesat e Rregullores së ZRRë-ja për vetëkonsumatorët me Burime të Ripërtërishme dhe se sistemi fotovoltaik i përbush të gjitha Standardet

Emri dhe mbiemri, nënshkrimi i personit përgjegjës të autorizuar nga kompania instaluese



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
the European Union

Teknike sipas thirrjes Nr. 01/2024 të datës 06.02.2024.	dhe vula.
--	-----------

Plotësimi i këtij formulari nënkupton autorizimin e institucionit që të përdorë të dhënat e përfshira në të për qëllime të këtij projekti!

Vërejtje: Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Neni 299 - Mashtrimi i blerësve “1. Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve vë në qarkullim prodhime me shenjën në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, llojit, prejardhjes apo kualitetit të produktit, vë në qarkullim produkte të cilat për nga pesha apo kualiteti nuk i përgjigjen asaj që rregullisht parashihet te produktet e tilla apo vë në qarkullim produkte pa shenjat që tregojnë për përmbajtjen, llojin, prejardhjen apo kualitetin e produktit kur shenja e tillë kërkohet me ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.

Emri dhe mbiemri i aplikuesit: _____

Nënshkrimi: _____ **Data:** ____ . ____ . ____ **Vendi:** _____